

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë asistent-lektor në Departamentin e Automatikës, kandidati duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

1. Të jetë diplomuar në ciklin e parë të studimeve Bachelor në Inxhinieri Mekatronike.
2. Të jetë diplomuar në ciklin e dytë të studimeve, Master i Shkencave, në Inxhinieri Mekatronike ose Inxhinieri Elektrike, drejtimi Automatizim i Industrisë.
3. Të ketë notë mesatare për lëndët matematikë, elektroteknikë, gjuhët e programimit, algoritëm dhe programim i avancuar, sistemet elektronike, PLC mbi 9.5.
4. Të ketë notë mesatare të dy cikleve të studimit mbi 8.5.
5. Përbën përparësi zotërimi i gradës shkencore "Doktor", në fushat mësimore dhe kërkimore që mbulon Departamenti i Automatikës.
6. Kanë përparësi kandidatët që zotërojnë titull akademik.
7. Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, dhënë si provim në institucionet ndërkombëtare.
8. Përbën përparësi eksperiencia në mësimdhënie në lëndët e PLC dhe Elektronikës.
9. Përbën përparësi eksperiencia e punësimit në kompanitë që punojnë me projektimin dhe zbatimin e sistemeve të automatizuara.
10. Kandidati duhet të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punojë në grup.

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Tekstilit dhe Modës kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë Lektor për lëndët:

- | | |
|---|--------|
| 1. Dizenjim Interiori | 6 ECTS |
| 2. Modelim Veshjesh | 6 ECTS |
| 3. Histori Arti | 3 ECTS |
| 4. Zhvillim Projektim Koncepti | 6 ECTS |
| 5. Praktika mësimore të studenteve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit sipas nevojave të departamentit. | |

Kriteret e propozuara për kandidatët janë si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare në Inxhinieri Tekstili (Cikli 5 vjeçar) ose Inxhinieri Tekstili dhe Modë (3 + 2).
2. Eksperiencë në mësimdhënie jo më pak se 10 vjet në fushat e mësipërme.

3. Eksperiencë në përdorimin e programeve kompjuterike CAD/CAM për modelimin e veshjeve, mundësisht kualifikime të dokumentuara me certifikata apo dëshmi.
4. Të mbajë gradën Doktor i Shkencave, cikli i tretë i studimeve ta këtë kryer ne Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, UPT, në fushën e materialeve tekstile.
5. Gjuhë e huaj e mbrojtur (një nga gjuhët e BE).

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **02.10.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.